



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Primar - Dorezuar Primjenic / Profato Received / Delivered	01.07.2022	2	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jednica Org. Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No	Shlojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMSHICK	3875	2022	117



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.435/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti-anëtarë si dhe Valentina Kaçandolli-Beketeshi, Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.435/2022 të datës 04.05.2022 të parashtruar nga ankuesja

me adresë rruga kundër organit të punësimit Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovë / Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në çështjen juridike "vlerësim i rezultateve të punës për vitin 2021", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 30.06.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.435/2022 e datës 04.05.2022 e parashtruar nga ankuesja
- II. MBETET në fuqi Formulari për Rivlerësimin e Rezultateve në Punë për periudhën 01.01.2021 deri me datë 16.05.2021, i datës 27.04.2022 dhe Formulari i Rivlerësimit të Rezultateve në Punë për periudhën 19.05.2021 deri me datë 31.12.2021, i datës 20.04.2022.

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, sipas Ndryshim dhe Plotësim të Akt emërimit me numër Nr.11/02/135/09 të datës 08.10.2014, në pozitën "Udhëheqëse e Sektorit të Pengut", në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovë, e cila me datë 02.02.2022 përmes emailit zyrtar ka pranuar formularin e vlerësimit të rezultateve të punës për vitin 2021 me notën e përgjithshme 2.7, nga Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. Lidhur me këtë ankuesja ka parashtruar komentet në formularin e vlerësimit për rezultatet e punës për vitin 2021.



Ankuesja, kundër vlerësimit të rezultateve në punës për vitin 2021, me datën 23.02.2022 ka parashtruar ankesën me nr.prot: 939/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore që vlerësimi i rezultateve në punës është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore, pa pasur asnjë njoftim për takim paraprak lidhur me vlerësimin e arritjes së objektivave gjatë vitit 2021, po ashtu ankuesja pretendon se vlerësimi i punës për vitin 2021, nuk është real, nuk është i drejte dhe se është i njëanshëm.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 03.03.2022, ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës, ndërsa me datën 15.03.2022, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës, me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Me datë 07.04.2022 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendim me numër Anr.154/2022, me të cilin e ka anuluar vlerësimin e rezultateve të punës janar - dhjetor 2021 dhe ka obliguar Udhëheqësin e drejtpërdrejtë të ankueses gjegjësisht Drejtorin e Drejtoratit për Çështje Administrative për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës, që ankueses ti bëhet rivlerësimi i rezultateve në punë brenda aftit ligjor.

Ankueses Pranvera Prestreshi, i është bërë ri-vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2021, nga dy mbikëqyrësit e saj, sipas Formularit të datës 22.04.2022 dhe të datës 27.04.2022, në bazë të obligimit ligjor të përcaktuar në Vendimin me numër Anr.154/2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 07.04.2022, për periudhën nga 01.01.2021 deri me datë 31.12.2021.

Me datë 22.04.2022 përmes E-mailit zyrtar nga SIMBNJ ankuesja është njoftuar, lidhur me përfundimin e ri-vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën nga data **19.05.2021 deri me datë 31.12.2021** nga Drejtori i Drejtoratit për Çështje Administrative për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës për të nënshkruar Formularin e datës 22.04.2022 për vitin 2021, i cili ka qenë udhëheqës i drejtpërdrejtë i ankueses për të cilën periudhë e ka ri-vlerësuar me notën e përgjithshme 2.8, mirëpo ankuesja ka dhënë komentet e saj në formular pasi ka qenë e pakënaqur me rivlerësimin e datës 22.04.2022 si dhe nuk e ka nënshkruar rivlerësimin.

Po ashtu, për periudhën dytë nga data 01.01.2021 deri me datë 15.05.2021, Drejtorja e Përgjithshme e Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës, si mbikëqyrëse e drejtpërdrejtë e ankueses me datë 27.04.2022 ka përfunduar ri-vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 gjegejsisht i ka derguar ankuesu permes emailit Formularin e ri-vlerësimit të rezultateve në punës për vitin 2021, të cilën e ka rivlerësuar me notën e përgjithshme (katër), 4.4 të cilin formular ankuesja nuk e kundërshton.

Ankuesja e pa kënaqur me Formularin e ri-vlerësimit të datës 20.04.2022, ka parashtruar ankesë me datë 04.05.2022 me numër protokolli 2557/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se ri-vlerësimi i rezultateve të punës për periudhën nga **19.05.2021 deri me datë 31.12.2021** nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë i cili e ka vlerësuar me notën e përgjithshme 2.8 nuk është i drejte, është tendencioz, nënçmues dhe mbi të gjitha është i kundërligjshëm dhe jo real për shkak se nuk ka marrë për bazë Vendimin me numër Anr.154/2022 me numër protokolli 1955/2022 të datës 07.04.2021 të KPMSHCK-së, si

dhe propozon që ti mblidhen dy vlerësimet dhe ti pjesëtohen me dy duke pretenduar që ti del nota e përgjithshme 3.6.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit me numër të protokollit 2557/2022 të datës 04.05.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-maili i datës 22.04.2022 njoftim; E-maili i datës 27.04.2022 Njoftim; Formularin e ri-vlerësimit të datës 22.04.2022, dhe Formulari i datës 27.04.2022; E-maili i datës 22.04.2022 i ankueses drejtuar E-mail i datës 15.04.2022; Raport Statistikor i datës 29.04.2022; Raport javor i datës 28.05.2021; Raport javor i datës 28.02.2022 i sektorit të pengut; E-mail i datës 23.12.2021; Raport javor i datës 23.12.2021 i sektorit të pengut; E-mail i datës 10.06.2021; Raport javor i datës 21.06.2021 i sektorit të pengut; E-mail i datës 08.07.2021; Raport javor i datës 08.07.2021 i sektorit të pengut; E-mail i datës 23.12.2021, i datës 22.12.2021; Raport javor nga janar-dhjetor 2021 i sektorit të pengut; E-mail i datës 14.10.2021; Raport javor i datës 14.10.2021 i sektorit të pengut; E-mail i datës 1.10.2021; Raport javor i datës 01.10.2021 i sektorit të pengut; E-mail i datës 05.01.2021; Raport javor i datës 05.01.2021 i sektorit të pengut; E-mail i datës 15.10.2021; E-mail i datës 26.04.2019; E-maili i datës 23.04.2019 me diferencat e raporteve në mes pageses; E-mail i datës 20.12.2021 raporte javore me e-mailat e bashkangjitur si më poshtë; E-mail i datës 31.12.2019; E-mail i datës 29.11.2019; E-mail i datës 30.12.2021; E-mail i datës 14.07.2021; Email i datës 01.07.2021; E-mail i datës 09.06.2021; E-mail i datës 08.06.2021; E-mail i datës 03.06.2021; E-mail i datës E-mail i datës 22.01.2021; 28.05.2021; E-mail i datës 26.05.2021; E-mail i datës 19.05.2021; E-mail i datës 18.05.2021; E-mail i datës 17.05.2021; E-mail i datës 22.02.2021; E-mail i datës 21.02.2021; E-mail i datës 18.01.2021; Vendim i datës 11.12.2020 i themelimit të komisionit për ankesa; E-mail i datës 28.05.2021; E-mail i datës 04.06.2021; E-mail i datës 11.06.2021; E-mail i datës 02.07.2021; E-mail i datës 09.07.2021; E-mail i datës 16.07.2021; E-mail i datës 23.07.2021; E-mail i datës 30.07.2021; E-mail i datës 06.08.2021; E-mail i datës 20.08.2021; E-mail i datës 13.08.2021; E-mail i datës 27.08.2021; E-mail i datës 17.09.2021; E-mail i datës 24.09.2021; E-mail i datës 01.10.2021; E-mail i datës 08.10.2021; E-mail i datës 15.10.2021; E-mail i datës 22.10.2021; E-mail i datës 29.10.2021; E-mail i datës 05.11.2021; E-mail i datës 12.11.2021; E-mail i datës 19.11.2021; E-mail i datës 26.11.2021; E-mail i datës 03.12.2021; E-mail i datës 10.12.2021; E-mail i datës 17.12.2021; E-mail i datës 24.12.2021; E-mail i datës 31.12.2021 dhe i datës 22.05.2022 për diskutim lidhur me ri vlerësimin e vitit 2021; **Ankesën** e ankuesit me numër të protokollit 939/2022 të datës 23.02.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopje e datës 02.02.2022 nga sistemi SIBMNJ-së vlerësimit të rezultateve në punës për vitin 2021; Raporti statistikor nga regjistri i pengut; Raporti Financiar nga Regjistri i pengut; Përgjigje në ankesë e datës 15.03.2022 nr. protokollit 1373/2022 nga Udhëheqësi i Divizionit të Burimeve Njerëzore; Ndryshim dhe Plotësim të Akt emërimit Nr.11/02/135/09 të datës 08.10.2014; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 08.10.2014; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punës të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimit publik për kategorinë drejtuese, i mesëm, i ulët dhe profesional për vitin 2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punës të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimit publik për kategorinë drejtuese i mesëm, i ulët dhe profesional për vitin 2020 ; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punës të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimit publik për kategorinë drejtuese i mesëm, i ulët dhe profesional për vitin 2019; Përgjigje sipas kërkesës në ankesë të

ankueses i datë 11.03.2022(E-mail); Kërkesë nga njësia e personelit për mbikëqyrësin e ankueses, për përgjigje në ankesën e ankueses sipas kërkesës së KPMSHCK-së.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar së pretendimet ankimore të ankueses *është e pa bazuar, sepse :*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave duke u bazuar në shkresat e lëndës ka analizuar ankuesen e ankueses të datës 04.05.2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe pretendimet ankimore të ankueses se ri-vlerësimi i rezultateve të punës për periudhën nga 16.05.2021 deri me datë 31.12.2021 i lëshuar nga Drejtori i Drejtoratit për Çështje Administrative për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës i cili e ka vlerësuar me notën e përgjithshme 2.8, është bërë jo i drejtë dhe jo real për shkak se nuk ka marrë për bazë Vendimin me numër Anr.154/2022 me numër protokolli 1955/2022 të datës 07.04.2021 të KPMSHCK-së, si dhe propozon që ti mblidhen dy vlerësimet dhe ti pjesëtohen me dy duke pretenduar që nota e përgjithshme ti del 3.6.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave duke u bazuar në shkresat e lëndës ka analizuar ankesën e ankueses të datës 04.05.2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe pretendimet ankimore të ankueses e cila e kundërshton Formularin e datë 20.04.2022 për ri-vlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2021, i lëshuar nga vlerësuesi i drejtpërdrejtë respektivisht Drejtori i Drejtoratit për Çështje Administrative për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës i cili e ka vlerësuar me notën e përgjithshme 2.8, dhe e cila pretendon se ri vlerësimi nuk është i drejtë dhe jo real sepse nuk janë marrë diskutuar objektivat dhe po ashtu nuk janë marr për bazë rrethanat dhe vështirësitë e periudhës së pandemisë ku edhe gjate asaj kohe ankuesja ka punuar

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankueses se është e pa kënaqur me rivlerësimin përfundimtarë të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë për vitin 2021, respektivisht me Formularin për Rivlerësimin e Rezultateve në Punë për periudhën 19.05.2021 deri me datë 31.12.2021, të datës 20.04.2022 duke theksuar se ri vlerësimi nuk është i drejtë, është tendencioz , nënçmues dhe mbi te gjitha është i kundërligjshëm dhe jo real sepse me rastin e rivlerësimit Udhëheqësi i drejtpërdrejtë ka bere rivlerësim formal dhe te kamufluar dhe se i njëjti nuk ka marr për bazë rrethanat dhe vështirësitë e periudhës se pandemisë se edhe pse ne te gjitha institucionet është punuar me rotacion ky sektor ka punuar vazhdimisht dhe i janë dërguar me kohe raportet periodike, javore, mujore tremujore dhe vjetore. Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankueses është i paqëndrueshme sepse në bazë të provave të lëndës është konstatuar se rivlerësimi i ankueses është bërë në pajtim me Rregulloren Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, respektivisht në pajtim me nenin 3 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 ku përcaktohet se *„Vlerësimi i rezultateve në punë - nënkupton një proces të përhershëm që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit i cili realizohet në pajtim me nenin 43 dhe 71 të Ligjit Nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë si dhe në pajtim me këtë Rregullore“.*

Po ashtu, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar dëshmitë e ofruara dhe pretendimet ankimore të ankueses ka konstatuar se janë të pa qëndrueshme, lidhur për faktin se ankuesja sipas Formularit të datës 22.04.2022 për ri-vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 për periudhën nga data 19.05.2021 deri me datë 31.12.2021 është ri vlerësuar nga Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë me notën e përgjithshme 2.8, në pajtim me nenin 43 paragrafin 5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, gjegjësisht Kolegji konstaton se ri-vlerësimi i ankueses për vitin 2021 me notën e përgjithshme 2.8, është bere në pajtim me nenin 11 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 dhe paragrafin 2 nën paragrafin 2.3 të Rregulloren Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, ku përcaktohet se: **"1. Objektivat dhe sjelljet profesionale do të vlerësohen me nota nga 1 deri në 5. Rezultati përfundimtar i vlerësimit llogaritet në bazë të mesatares së marrë dhe paraqitur si në vijim:..... nën paragrafin 1.3. "nga 2.5 deri më pak se 3.5 nënkupton "mirë", dhe paragrafi 2. "Kuptimi i notave si në paragrafin 1 të këtij neni është si në vijim:.... nën paragrafin 2.3. "mirë", vlerësohet nëpunësi, i cili ka realizuar të gjitha objektivat e punës, dhe ka treguar aftësi të pritshme të punës", sepse në rastin konkret Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankueses, për periudhën 19.05.2021 deri me datë 31.12.2021, ankuesen e ka vlerësuar me notën e përgjithshme 2.8, dhe ky vlerësim e ka kuptimin e notës "mirë", duke nënkuptuar se ankuesja i ka realizuar të gjitha objektivat e punës, dhe ka treguar aftësi të pritshme të punës, siç e përcaktojnë dispozitat e lartë cekura, e që në fakt mbikëqyrësi i ka marrë parasysh rrethanat, vështirësitë dhe përpjekjet e ankueses gjatë kryerjes së detyrave të punës, për këtë periudhë të raportimit të saj, përmes shkresave zyrtare të bashkangjitura në provat e lëndës, andaj bazuar në këto konstatime pretendimet e ankueses janë të pa bazuara.**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës/Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, me rastin e pranimit të Vendimit me numër Anr.154/2022 të datës 07.04.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovë, lidhur me ankesën e ankueses të parashtruar në Këshill me datë 23.02.2022 në çështjen juridike **"Vlerësim i rezultateve në punë për vitin 2021"**, sipas obligimit ligjor është zbatuar brenda afitit ligjor, të përcaktuar në pikën II të diapozitivit, duke i bërë ankueses ri-vlerësimin e rezultateve të punës për periudhën nga data 01.01.2021 deri me datës 31.12.2021 nga Udhëheqësit e drejtpërdrejtë të ankueses, duke vepruar në pajtim me nenin 43 paragrafin 5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet se: **"5. Nëpunësi civil vlerësohet nga mbikëqyrësi i tij i drejtpërdrejtë. Në rastin e ndërrimit të mbikëqyrësit përpara përfundimit të vlerësimit vjetor, ai vlerëson nëpunësin vetëm për periudhën përkatëse", dhe neni 5 paragrafin 2 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, ku përcakton se: "2.Nëse gjatë periudhës së vlerësimit, ndërrohet mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i nëpunësit para përfundimit të vlerësimit vjetor, ai vlerëson nëpunësin vetëm për periudhën përkatëse, ndërsa për periudhën e mbetur të vlerësimi vjetor, vlerësimi bëhet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejt pasues".**

Ankuesen me datë 20.04.2022 Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë e ka ri-vlerësuar duke lëshuar Formularin për vlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2021, për periudhën nga data 19.05.2021 deri me datë 31.12.2021, duke e vlerësuar me notën e përgjithshme 2.8, të cilin formular ankuesja nuk e ka nënshkruar edhe pse është ftuar nga mbikëqyrësi kurse Formularin e lëshuar me datë 27.04.2022 të ri-vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2021, për periudhën nga data 01.01.2021 deri me datë 15.05.2021 të Mbikëqyrëses së drejtpërdrejtë

nuk e kundërshton, për të cilën periudhë ankuesja është vlerësuar me notën e përgjithshme 4.4, ku i ka dhënë komentet në pjesën e II-të, duke theksuar se: *ankuesja i ka realizuar të gjitha detyrat e parapara ne plan te punës...* andaj, ankuesja formularin e datës 27.04.2022 nuk e kundërshton.

Duke u bazuar në faktet e lartcekura, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se ankuesja sipas Formularit të ri-vlerësimit të datës 20.04.2022 është vlerësuar me notën e përgjithshme 2.8 dhe Formularin e ri-vlerësimit të datës 27.04.2022 është vlerësuar me notën e përgjithshme 4.4 respektivisht nga të dy mbikëqyrësit e drejtpërdrejtë, është vlerësuar se ankuesja ka realizuar të gjitha objektivat e punës, dhe ka treguar aftësi të pritshme të punës, andaj lidhur me këtë Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se ri vlerësimi për vitin 2021 për ankuesen është bërë për dy periudha respektivisht për pesë mujorin e parë të vitit 2021, gjegjësisht nga data 01.01.2021 deri me datë 16.05.2021 e vlerësuar me notë të përgjithshme 4.4 dhe për shtatë mujorin e dytë të vitit 2021 gjegjësisht nga data 19.05.2021 deri në fund të dhjetorit 2021, e cila është vlerësuar me notën e përgjithshme 2.8, këtë të fundit ankuesja e kundërshton dhe i cili vlerësim e ka kuptimin e notës „mirë”, dhe në kuptim të kësaj Kolegji konstaton se rivlerësimi për rezultatet e punës për ankuesen për periudhën 19.05.2021 – dhjetor 2021, është bërë pozitiv e që është në pajtim me dispozitën ligjore të nenit 11 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 dhe paragrafin 2 nën paragrafin 2.2 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, ku përcaktohet se: *“1. Objektivat dhe sjelljet profesionale do të vlerësohen me nota nga 1 deri në 5. Rezultati përfundimtar i vlerësimit llogaritet në bazë të mesatares së marrë dhe paraqitur si në vijim: 1.3. nga 2.5 deri më pak se 3.5 nënkupton “mirë”, si dhe 2. Kuptimi i notave si në paragrafin 1 të këtij neni është si në vijim: “2.3. “mirë”, vlerësohet nëpunësi, i cili ka realizuar të gjitha objektivat e punës, dhe ka treguar aftësi të pritshme të punës, dhe në rastin konkret Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave konstaton se ankuesja ka realizuar të gjitha objektivat e punës dhe se rivlerësimi i rezultateve të punës për periudhën janar-dhjetor 2021 ka qenë objektiv dhe i drejtë, kurse për pretendimin tjetër që ti mblidhen dy vlerësimet dhe ti pjesëtohen me dy duke pretenduar që nota e përgjithshme ti mbetet 3.6, ky pretendim nuk është i bazuar sepse dispozitat ligjore të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, nuk kanë parapare këtë mundësi dhe pretendimi si i tillë është i pa bazë dhe i pa qëndrueshëm.*

Andaj, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës, me qëllim të zbatimit të Vendimit me numër Anr.154/2022 të datës 07.04.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokolli 1955/2022, ka ndërmarre të gjitha veprimet në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën Administrative dhe të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, lidhur me ri-vlerësimin e rezultateve të punës për ankuesen për periudhën janar – dhjetor 2021, respektivisht Kolegji konstaton se me rastin e rivlerësimit të rezultateve të punës për ankuesen sipas formularit të datës 20.04.2022 dhe formularit të datës 27.04.2022 të nënshkruar nga mbikëqyrësit e drejtpërdrejtë, është vërtetuar drejtë gjendja faktike dhe baza juridike dhe se Njësia e Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës/Ministria e Industrisë,

Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, është e obliguar që formularët e fundit me të cilët është bërë rivlerësimi ti vendos në dosjen e ankueses dhe në sistemin elektronik SIMBNJ-së, duke ju bashkangjitur dhe këtë vendim.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se në bazë të provave të lëndës është vërtetuar se ankuesja është rivlerësuar drejtë lidhur me vlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2021, sepse nota e përgjithshme pas rivlerësimit është në pajtim me komentet, dhe rrjedhimisht në rastin konkret udhëheqësit e drejtpërdrejtë të ankueses pas rivlerësimit kanë respektuar dispozitat e nenit 43 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik si dhe nenit 3 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.


Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, të Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.435/2022.

Valentina KAÇANDOLLI-BEKETESHI

Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës,
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës dhe
- Arkivat të KPMSHCK-së.